

**PROCEDURA DI SELEZIONE PER
LA COPERTURA DI 113 POSTI
PER L'ACCESSO AL
PROFILO PROFESSIONALE DI
TRADUTTORE INTERPRETE,
POSIZIONE ECONOMICA C1.**

Quesiti per la lingua albanese

Per facilità di consultazione, per ciascun quesito, la risposta esatta è indicata sempre con la lettera "A".

001. Folja "këndoja" është në mënyrën dëftore dhe në kohën e...

- A) Pakryer. B) Kryer të thjeshtë.
C) Kryer. D) Tashme.

002. Në vargun : "Ti Shqipëri më jep nder, më jep emrin shqipëtar (Naim Frashëri)" « më » është :

- A) Trajtë e shkurtër e përemrit vetor. B) Përemër vetor.
C) Përemër pronor. D) Përemër dëftor.

003. Në pjesën : "Kur shfleton poezinë popullore... ke dëshirë të jetosh, të lindësh fëmijë, të jesh nënë, të jesh baba... (I : Kadare) », Në çfarë mënyre janë foljet e nënvizuara ?

- A) Lidhore. B) Dëftore.
C) Kushtore. D) Urdhërore.

004. Fjalja: " Ti qofsh me jetë more biri im", është fjali:

- A) Dëshirore. B) Nxitëse.
C) Dëftore. D) Thirrmore.

005. Sa mënyra të foljes ekzistojnë në gjuhën shqipe ?

- A) 6. B) 5.
C) 4. D) 7.

006. Foljet në gjuhën shqipe janë kalimtare dhe jo kalimtare. Foljet kalimtare:

- A) Shprehin veprime që bien mbi një send ose frymor. B) Shprehin veprime që mbeten tek ai që i kryen.
C) Janë folje që ndërrojnë vendin me emrin në fjali. D) Janë folje që përdoren si kryefjalë.

007. Kundrinori i drejtë i përgjigjet pyetjes :

- A) Kë. B) Kujt.
C) I, e kujt. D) Kush.

008. Vendos foljen "lexoj" në kohën e tashme të mënyrës kushtore:

- A) Do të lexoja. B) Lexova.
C) Lexuar. D) Kam lexuar.

009. Në cilën rrokje bie në të shumtën e rasteve theksi i fjalës në gjuhën shqipe?

- A) Në rrokjen e parafundit. B) Në rrokjen e parë.
C) Në rrokjen e fundit. D) Në rrokjen e mesit.

010. Emri: " gjyshit" është në rasën :

- A) Dhanore. B) Gjinore.
C) Emrore. D) Rrjedhore.

011. Në çfarë shkalle është ndajfolja në fjalinë e mëposhtme:

"Ai është shumë i gëzuar"?

- A) Sipërore. B) Krahasore e sipërisë.
C) Krahasore e ultësisë. D) Pohore.

012. Gjuha ka tre regjistra.

- A) Po, regjistër të thjeshtë, të zakonshëm e libror. B) Jo, nuk ka asnjë regjistër.
C) Po, të thjeshtë, të figurshëm e libror. D) Jo, ka vetëm regjistër libror.

013. Fjalët e prejardhura futen në grupin e fjalëve:

- A) Jo të thjeshta. B) Me kuptim të dyfishtë.
C) Të përbëra. D) Të thjeshta.

014. Homonimet: "vesh"(rrobat) dhe "vesh"(i foli në) janë:

- A) Homonime të pjesshme. B) Parësore.
C) Të mirëfillta. D) Dytësore.

015. Në fjalinë : "Të martën e shkuar, Andi, pati ditëlindjen", fjalët e nënvizuara janë në rolin e :

- A) Rrethanorit të kohës. B) Kallzuesorit.
C) Përcaktorit të kohës. D) Kundrinorit.

016. Sa lloje përemrash kemi?

- A) 6. B) 4.
C) 5. D) 7.

017. Foljet, tema e të cilave mbaron me zanore dhe në vetën e parë njëjës të kohës së tashme, marrin mbaresën "j", në çfarë zgjedhimi janë?

- A) Në të parin. B) Në të tretin.
C) Në të dytin. D) Në të katërtin.

018. Gjej temën në formën foljore "përqafojm"

- A) Përqafo. B) Përqafim.
C) Qafë. D) Përqafoj.

019. Pjesëzat bëjnë plotësimet në kuptimin e një fjale ose të një fjalie.

- A) Po. B) Jo.
C) Ndajné dy fjali. D) Ndajné dy fjalë.

020. Fjala "lamtumirë" në rastin: "Lamtumirë nënë", është:

- A) Pashirrmë. B) Parafjalë.
C) Ndajfolje. D) Emër.

021. Vendos emrin "ftua" në rasën dhanore, trajta e pashquar, njëjës.

- A) Një ftoi. B) Ftua.
C) Një ftua. D) I e ftoit.

022. Sa zgjedhime ka folja në gjuhën shqipe?

- A) 3. B) 2.
C) 4. D) 1.

023. Vendos emrin "fletë" në trajtën e pashquar, shumës, rase emërore:

- A) Fletë. B) Fletëve.
C) Fletët. D) Prej fletëve.

024. Cila mënyrë ka më shumë kohë foljesh?

- A) Dëftore. B) Lidhore.
C) Kushtore. D) Urdhërore.

025. Onomastika është degë e gjuhësisë që studion:

- A) Emrat e përvetshëm. B) Fjalët në përgjithësi.
C) Emrat e përgjithshëm. D) Foljet.

026. Shndërrimi nga "lulet rriten" në "rritja e luleve" quhet shndërrim:

- A) Emëror. B) Pësor.
C) Foljor. D) Përemëror.

027. Shenja e pikësimit në fund të fjalisë nxitëse është:

- A) Pikë. B) Pikëpyetje.
C) Pikëçuditëse. D) Dy pika.

028. Fjalja dëshirore mund të jetë mohore dhe pohore?

- A) Po. B) Vetëm pohore.
C) Vetëm mohore. D) As pohore as mohore.

029. Në çfarë shkalle është mbiemri në fjalinë: "Mali i Korabit është më i lartë se mali i Dajtit"?

- A) Shkalla krahasore e sipërisë. B) Shkalla krahasore e përgjithësuar.
C) Shkalla sipërore. D) Pohore.

030. Grupi emëror është grupi i fjalëve që përbëhet nga

- A) Një emër dhe përcaktuesit e saj. B) Nga dy emra me kuptim të njëjtë.
C) Emër + mbiemër. D) Emër + folje.

031. Në çfarë trajte, rase dhe numri është mbiemri i nënvizuar: "Të ftohtit të sotëm"?

- A) Trajta e shquar, rase dhanore, numri njëjës. B) Trajta e shquar, rase emërore, numri njëjës.
C) Trajta e pashquar, rase emërore, numri shumës. D) Trajta e shquar, rase emërore, numri shumës.

032. Fjala e nënvizuar në fjalinë: "Të gjithë të ftuarit duartrokitën" është:

- A) Përemër i pacaktuar. B) Përemër pronor.
C) Përemër sasië. D) Përemër vetor.

033. Folja "paskëshim" është në:

- A) Kohën e pakryer të mënyrës habitore. B) Kohën e tashme të mënyrës dëshirore.
C) Kohën e kryer të mënyrës habitore. D) Kohën e kryer të mënyrës dëshirore.

034. Një vazhdim fjalish ku flitet për të njëjtën temë, quhet:

- A) Tekst. B) Fjali e bashkërenditur.
C) Fjali e përbërë. D) Fjali e nënrenditur.

035. "Të sajit" është përemër pronor në:

- A) Rasën dhanore, njëjës. B) Rasën kallzore njëjës.
C) Rasën dhanore shumës. D) Rasën kallzore shumës.

036. "Ikja" është:

- A) Emër. B) Përemër.
C) Folje. D) Ndajfolje.

037. Në fjalinë: "Vajza, e skuqur nga turpi, uli kokën", mbiemri është:

- A) Përcaktor i veçuar i emrit. B) Kallëzuesor i kryefjalës.
C) Përcaktor i paveçuar i emrit. D) Kallëzuesor.

038. Brendapërbrenda fjalisë fjalët luajnë:

- A) 5 funksione. B) 3 funksione.
C) 4 funksione. D) 6 funksione.

039. Në vargjet e Naimit: "...Ashtu dhe zemra ime, më lë këtu tek jam mua, vjen me vrap e me dëshirë, atje ndër viset e tua..." pjesa e nënvizuar është:

- A) Rrethanor i mënyrës. B) Rrethanor i qëllimit.
C) Rrethanor i kohës. D) Rrethanor i vendit.

040. "Lagur, djegur", janë:

- A) Pjesore. B) Paskajore.
C) Përcjellore. D) Ndajfolje.

041. Sa lakime ka emri në gjuhën shqipe?

- A) 3. B) 4.
C) 2. D) 5.

042. Në fjalinë: "Mira është shoqja ime", -ime- është përemër:

- A) Pronor. B) Vetvetor.
C) Dëftor. D) Lidhor.

043. Gjuha shqipe ka 36 shkronja dhe sa fonema?

- A) 36. B) 29.
C) 30. D) 7.

044. Pyetja për të gjetur kryefjalën e fjalisë i drejtohet:

- A) Kallëzuesit. B) Rrethanorit.
C) Kundrinorit. D) Përcaktorit.

045. Kryefjala e fjalisë i përgjigjet pyetjes:

- A) Kush? B) Kë?
C) Kujt? D) Sa?

046. Sa gjini ka emri në gjuhën shqipe?

- A) 3. B) 4.
C) 2. D) Asnjë.

047. Fjalët brendapërbrenda fjalisë a mund të kryejnë edhe funksionin -përcaktor-?

- A) Po. B) Kryejnë vetëm funksionin -kallzuesor-.
C) Jo. D) Kryejnë vetëm funksionin -rrethanor-.

048. Fjalët brendapërbrenda fjalisë a mund të kryejnë edhe funksionin -ndajshim-?

- A) Po. B) Kryejnë vetëm funksionin -kallzuesor-.
C) Jo. D) Kryejnë vetëm funksionin -rrethanor-.

049. Vendos foljen -kam- në kohën më se të kryer, në vetën e parë shumës të mënyrës dëftore.

- A) Kishim pasur. B) Kemi pasur.
C) Patëm pasur. D) Të kishim pasur.

050. Folja "paskam pasur" është në:

- A) Kohën e kryer të mënyrës habitore. B) Kohën e pakryer të mënyrës habitore.
C) Kohën më se të kryer të mënyrës habitore. D) Kohën e tashme të mënyrës kushtore.

051. A mund të jetë emri, përcaktor i një mbiemri bërthamë?

- A) Po. B) Vetëm mbiemri përcakton emrin.
C) Emri nuk përcakton mbiemrin. D) Emri përcakton vetëm emrin.

052. Gjej mbiemrin e nyjshëm:

- A) E bukur. B) Nga bukuria.
C) Për bukuria. D) Bukuroshe.

053. Cilët përemra duke i shqiptuar, shpesh shoqërohen me gjeste për të treguar sende o frymorë të caktuar?

- A) Përemrat dëftorë. B) Përemrat pronorë.
C) Përemrat lidhorë. D) Përemrat e pacaktuar.

054. Për të folur përdorim laringun.

- A) Po. B) Jo, përdorim vetëm buzët dhe dhëmbët.
C) Jo, përdorim vetëm buzët. D) Jo, përdorim gojën dhe fytyrën.

055. Si shënohen pauzat në të shkruar?

- A) Me shenja të ndryshme të pikësimit. B) Vetëm me tre pika.
C) Vetëm me pikë. D) Vetëm me presje.

056. Shndërrimi: "Nxënësit e donin mësuesin" në "mësuesi duhej nga nxënësit" është:

- A) Shndërrim pësor. B) Shndërrim vepror.
C) Shndërrim vetvetor. D) Shndërrim ndajfoljor.

057. "Nxënësi që lexon". Pjesa e nënvizuar është:

- A) Pjesë e nënrenditur përcaktore. B) Pjesë e bashkërenditur përcaktore.
C) Pjesë e nënrenditur e mënyrës. D) Pjesë e bashkërenditur e mënyrës.

058. Vendos foljen "gjej" në kohën e tashme të mënyrës dëshirore, veta e tretë njëjës.

- A) Gjettë. B) Gjetkësh.
C) Gjesh. D) Gjetshit.

059. Vendos mbiemrin " e ve (grua)" në rasën kallzore, numri njëjës.

- A) (Gruan) e ve. B) (Gruaja) e ve.
C) (i e gruas) së ve. D) (Gruas) së ve.

060. Fjala "këtij" është:

- A) Përemër dëftor. B) Ndajfolje vendi.
C) Përemër lidhor. D) Parafjalë.

061. Në fjalinë "Mësuese Pranvera është shumë e mirë me nxënësit" gjej ndajshtimin:

- A) Mësuese. B) Nxënësit.
C) Pranvera. D) Shumë.

062. A mund të përdoret përemri vetor si kryefjalë e fjalisë?

- A) Po. B) Jo, vetëm si përcaktor.
C) Jo, vetëm si kundrinor. D) Jo, vetëm si rrethanor.

063. Në fjalinë: "Ne biseduam gjërë e gjatë për të", -për të - është në funksionin e një:

- A) Kundrinori të zhdrejtë me parafjalë. B) Rrethanori me parafjalë.
C) Kundrinori të zhdrejtë pa parafjalë. D) Parafjalë.

064. Në fjalinë: "Arbeni po i bërtiste asaj" përemri -asaj- është në funksionin e një:

- A) Kundrinori të zhdrejtë pa parafjalë. B) Rrethanori me parafjalë.
C) Kundrinori të zhdrejtë me parafjalë. D) Parafjalë.

065. Çfarë përemrash janë: -asaj-, -për të-?

- A) Vetor. B) Pyetës.
C) Dëftor. D) Lidhor.

066. Brenda fjalisë mund të bëhen këto veprime: zgjerime, zëvendësime si edhe:

- A) Ngushtime. B) Mbyllje.
C) Hapje. D) Këputje.

067. Fjalitë me një gjymtyrë kryesore të shprehur me folje mund të jenë:

- A) Vetore, pavetore. B) Vetëm vetore.
C) Vetore, vetvetore. D) Vetëm vetvetore.

068. Ritmi i fjalisë është përsëritja e:

- A) Theksave dhe pauzave sipas një rregulle të caktuar. B) Rrokjeve në mënyrë të njëjtë.
C) Fjalëve. D) Fjalëve me të njëjtin ritëm.

069 Në fjalinë: "Kuajt ishin të lodhur pas garës", mbiemri -të lodhur- është në rolin e:

- A) Kallëzuesorit të kryefjalës. B) Kallëzuesorit të mbiemrit.
C) Kallëzuesorit të përemrit. D) Përcaktorit.

070. Në fjalinë: "Ajo mendohej të fshihte sytë që i kishte të skuqur", mbiemri -të skuqur- është në funksionin e:

- A) Kallëzuesorit të kundrinorit të drejtë. B) Kallëzuesorit të mbiemrit.
C) Kallëzuesorit të kryefjalës. D) Përcaktorit.

071. Vendos foljen -shkoj- në mënyrën habitore.

- A) Shkuake. B) Shkofsh.
C) Do të shkoje. D) Të shkosh.

072. -Mësohesha është në kohën e:

- A) Pakryer. B) Tashme.
C) Kryer. D) Ardhme.

073. Gjej kryefjalën e fjalisë: "Të gjithë po lexonin librin me zë të ulët"

- A) Të gjithë. B) Zë.
C) Librin. D) Të ulët.

074. Në fjalinë: "Ai pastë të drejtë", -pastë- është folja:

- A) Kam. B) Shkoj.
C) Jam. D) Vij.

075. Fjalët që kanë të njëjtin kuptim quhen:

- A) Sinonime. B) Homonime.
C) Antonime. D) Formale.

076. Shprehje frazeologjike quhen:

- A) Përdorimet e ngurosura të një fjale. B) Anekdotat.
C) Përdorimi i fjalëve sinonimike. D) Përdorimi i një fjalie në vend të një tjetre.
-

077. Shprehja frazeologjike: "fill e për pe", është:

- A) Ndajfoljore. B) Emërore.
C) Mbiemërore. D) Foljore.
-

078. Shprehja frazeologjike: "fol e qesh" është:

- A) Mbiemërore. B) Emërore.
C) Ndajfoljore. D) Foljore.
-

079. Jep një shembull regjistri të gjuhës:

- A) I ngritur. B) I saktë.
C) I ulur. D) Natyror.
-

080. Fjala është:

- A) Njësia e mëvetësishme më e vogël e gjuhës. B) Pjesa e pandryshueshme e ligjëratës.
C) Tërësia e bashkëtingëlloreve dhe e zanoreve. D) Fjalë janë vetëm folja dhe emri.
-

081. "Belhollë" është fjalë e:

- A) Përbërë. B) Prejardhur.
C) Përngjitur. D) E thjeshtë.
-

082. Që të formohet një rrokje duhet patjetër prania e :

- A) Një foneme zanore. B) Dy fonemave zanore.
C) Një foneme bashkëtingëllore. D) Dy fonemave bashkëtingëllore.
-

083. Në fjalinë: "Ajo kishte sytë e zinj", -e zinj- është në gjininë:

- A) Mashkullore. B) Asnjanëse.
C) Femërore. D) Pjesore.
-

084. Folja -lyeni- është në kohën e:

- A) Tashme. B) Pakryer.
C) Kryer. D) Ardhme.
-

085. A,B,E,H,J,etj janë:

- A) Fonema. B) Rrokje.
C) Morfema. D) Zanore.
-

086. Parashtesat janë:

- A) Morfema. B) Emra.
C) Fonema. D) Folje.
-

087. Fonema është:

- A) Njësia më e vogël e sistemit tingullor të gjuhës që shërben për të ndërtuar fjalë.
B) Njësia më e vogël e kuptimshme në përbërjen e fjalëve.
C) Gjithmonë një zanore.
D) Gjithmonë një bashkëtingëllore.
-

088. "Thënkësh" është në:

- A) Kohën e pakryer të mënyrës habitore. B) Kohën e tashme të mënyrës habitore.
C) Kohën e kryer të mënyrës habitore. D) Kohën e ardhme të mënyrës dëftore.
-

089. "T" është bashkëtingëllore:

- A) Gjuhore. B) Hundore.
C) Grykore. D) Dhëmbore.
-

090. Pjesa e gramatikës që studion mënyrën si lidhen fjalët ose fjalitë midis tyre quhet:

- A) Sintaksë. B) Sintetizëm.
C) Morfologji. D) Sinkroni.
-

091. Pjesa e gramatikës që merret me studimin e trajtave të fjalëve dhe të kategorive gramatikore të tyre quhet:

- A) Morfologji. B) Sintetizëm.
C) Sintaksë. D) Sinkroni.
-

092. Fjala " i përbotshëm" është fjalë e:

- A) Prejardhur. B) E thjeshtë.
C) Përngjitur. D) E përbërë.
-

093. Fjala "përnjëherë" është fjalë e:

- A) Përngjitur. B) E thjeshtë.
C) Prejardhur. D) E përbërë.
-

094. "Kësaj" është:

- A) Rasa dhanore e përemrit dëftor. B) Rasa dhanore e përemrit pronor.
C) Rasa gjinore e përemrit dëftor. D) Rasa gjinore e përemrit pronor.

095. A mund të jetë një mbiemër ,fjalë përcaktuese e emrit në fjali?

- A) Po. B) Jo, mbiemri nuk përcakton emrin.
C) Vetëm përemri përcakton emrin. D) Vetëm ndajfolja përcakton emrin.

096. Pjesa e ligjëratës që shënon një veprim a gjendje quhet:

- A) Folje. B) Emër.
C) Ndajfolje. D) Përemër.

097. Në çfarë rase është përemri "i tëndit"?

- A) Gjinore. B) Dhanore.
C) Rrjedhore. D) Kallëzore.

098. Një grup emëror mund të zëvendësohet nga një përemër?

- A) Po.
B) Po, vetëm kur emri është i gjinisë mashkullore.
C) Jo.
D) Vetëm kur emri është në numrin njëjës.

099. Përemri "ne, na" është në rasën :

- A) Kallëzore.
B) Dhanore.
C) Rrjedhore.
D) Emërore.

100. Rasa gjinore e përemrit "unë" është:

- A) -. B) Prej meje.
C) Mua më. D) Unë.

101. A ka fjali të përbëra që lidhen pa fjalë lidhëse ose lidhëza?

- A) Po. B) Jo.
C) Lidhen vetëm me lidhëza. D) Lidhen vetëm me fjalë lidhëse.

102. Në fjalinë e përbërë: "Ecte ngadalë që të mos i prishte gjumin" pjesa e nënrenditur është:

- A) Qëllimore. B) Filluese.
C) Kushtore. D) Lejore.

103. Gjej temën e fjalës "lundroja":

- A) Lundro. B) Lundër.
C) Lundroj. D) Lund.

104. Folja "dremit" është:

- A) Kalimtare. B) Jokalimtare.
C) Kalimtare e drejtë D) Jokalimtare e drejtë.

105. Në fjalinë: "të thashë një herë" -një herë është:

- A) Ndajfolje sasive. B) Parafjalë.
C) Ndajfolje vendi. D) Ndajfolje shkaku.

106. "Në lidhje me këtë problem", -në lidhje me- është:

- A) Shprehje parafjalore. B) Shprehje ndajfoljore.
C) Parafjalë. D) Ndajfolje.

107. Parashitesat janë:

- A) Elemente të fjalës. B) Zanore.
C) Fjalë. D) I ngjiten mbaresës.

108. Fjalët: "i verdhë", "verdhësi", "zverdh", formojnë një :

- A) Familje fjalësh. B) Familje të thjeshtë.
C) Fushë leksikore. D) Fushë fonetike.

109. Fjalët "i verdhë", "i florinjte", "i limonte", formojnë një:

- A) Fushë leksikore. B) Familje të thjeshtë.
C) Familje fjalësh. D) Fushë fonetike.

110. Cila fjalë është shkruar saktë:

- A) Duzinë. B) Duzin'.
C) Dyzinë. D) Dyzin'.

111. Fjalët që kanë shumë kuptime quhen:

- A) Polisemantike. B) Fjalë të përbëra.
C) Kuptimore. D) Fjalë me dy kuptime.

112. "Përse?" është:

- A) Ndajfolje qëllimi. B) Ndajfolje shkak.
C) Parafjalë. D) Lidhës.
-

113. "Pse?" është:

- A) Ndajfolje shkak. B) Ndajfolje qëllimi.
C) Parafjalë. D) Lidhës.
-

114. Etika është shkenca që studion:

- A) Moralin. B) Vjetërsinë e fjalës.
C) Prejardhjen e fjalës. D) Fjalën.
-

115. Etimologjia studion:

- A) Prejardhjen e fjalës. B) Vjetërsinë e fjalës.
C) Moralin. D) Fjalën.
-

116. Vendos përemrin "ne" në rasën dhanore shumë:

- A) Neve (na). B) Ne (na).
C) Nesh. D) Prej nesh.
-

117. Vendos përemrin "ne" në rasën rrjedhore:

- A) Prej nesh. B) Ne (na).
C) Nesh. D) Neve (na).
-

118. Në fjalinë "Ajo vajzë qenka shumë e bukur", gjej përemrin dëftor dhe grupin emëror ku bën pjesë:

- A) Ajo, ajo vajzë. B) Shumë, shumë e bukur.
C) E, e bukur. D) Bukur, vajzë e bukur.
-

119. Sipas kuptimit dhe funksionit në fjali, sa lloje ndajfoljesh kemi:

- A) 6. B) 5.
C) 4. D) 7.
-

120. Pjesa e foljes që i ngjitet temës dhe ndryshon gjatë zgjedhimit të foljes quhet:

- A) Mbaresë. B) Prapashtesë.
C) Parashtesë. D) Zanore.
-

121. Fjalët: "afër", "larg", "buzë" janë:

- A) Parafjalë ose ndajfolje. B) Ndajfolje.
C) Parafjalë. D) Folje.
-

122. Libri i parë i gjetur i gjuhës shqipe është "Meshari" i Gjon Buzukut i vitit:

- A) 1555. B) 1550.
C) 1554. D) 1560.
-

123. Gjej fjalën e shkruar në mënyrë të rregullt:

- A) Vetëshërbim. B) Vetë-shërbim.
C) Vetshërbim. D) Vet-shërbim.
-

124. "Për të hapur" është:

- A) Paskajore. B) Folje.
C) Përcjellore. D) Emër.
-

125. Në cilën kohë vendoset folja për të treguar një veprim të përfunduar para një çasti të caktuar në të shkuarën?

- A) E kryer të tejshkuar. B) Të pakryer.
C) E kryer. D) Të kryer të thjeshtë.
-

126. Vendos foljen "vij" në kohën e ardhme të mënyrës lidhore.

- A) -. B) Do të kem ardhur.
C) Do të vija. D) Të vija.
-

127. Vendos foljen "vij" në kohën e pakryer të mënyrës lidhore.

- A) Të vija. B) Të vij.
C) -. D) Do të vija.
-

128. Vendos foljen "mësoj" në kohën më se të kryer, veta e tretë njëjës të mënyrës habitore.

- A) Paskësh mësuar. B) -.
C) Paskam mësuar. D) Paskëshit mësuar.
-

129. Fjala "parandaloj" është fjalë e :

- A) Përbërë. B) Përngjitur.
C) E thjeshtë. D) Përzier.
-

130. Nga mënyra e formimit lidhëza "mirëpo" është e:

- A) Përngjitur. B) Përzier.
C) Thjeshtë. D) Ndërlikuar.
-

131. Vendos fjalën e shkruar saktë në fjalinë: "... është e saktë".

- A) Përgjigjja. B) Përgjigjia.
C) Përgjigja. D) Përgjigje.
-

132. Kur një fjale i shtohet një prapashtesë, fjala quhet:

- A) E prejardhur. B) E përbërë.
C) E thjeshtë. D) E ndërlikuar.
-

133. Fjala "dritëdhënës" është formuar:

- A) Emër + emër. B) Emër + përemër.
C) Emër + folje. D) Emër + prapashtesë.
-

134. Si quhet qyteti, një pjesë e të cilit ruhet pa u prekur për ndërtimet me vlerë nga e kaluara?

- A) Qytet-muze. B) Qytet arti.
C) Vepër arti. D) Qytet antik.
-

135. Sistemi i rregullave për të shkruar saktë fjalët quhet:

- A) Drejtshkrim. B) Rregullore.
C) Drejtshqiptim. D) Fjalor.
-

136. Në fjalitë e përbëra, pjesa e nënrenditur e barazisë ndahet nga pjesa kryesore me:

- A) Presje. B) Pikë.
C) Dy pika. D) Pikëpresje.
-

137. Fjalja "Atë ditë u zgjova shpejt, mora kapelen, veshja pallton dhe dola" është fjali e përbërë me më shumë se dy pjesë...

- A) Të bashkërenditura. B) Me lidhje të përzier.
C) Të nënrenditura. D) Me tre pjesë të nënrenditura.
-

138. Në çfarë kohe është folja -u gëzuam-?

- A) E kryer e thjeshtë. B) E pakryer.
C) E kryer. D) Më se e kryer.
-

139. Format e ndryshme që merr folja për të shprehur një veprim ose gjendje, i quajmë:

- A) Mënyra të foljes. B) Lakime të foljes.
C) Zgjedhime të foljes. D) Zgjerime të foljes.
-

140. Paskajorja:

- A) Nuk ndryshon as sipas kohës, vetës e as sipas numrit.
B) Nuk ndryshon vetëm sipas vetës.
C) Ndryshon sipas numrit.
D) Nuk ndryshon vetëm sipas vetës e numrit.
-

141. Sa kohë të prejardhura të foljes kemi?

- A) 4. B) 6.
C) 5. D) 3.
-

142. Zgjidh fjalën e shkruar saktë:

- A) Sfungjer. B) Sfyngjere.
C) Sfungjere. D) Sfyngjer.
-

143. Fjalët mund të jenë:

- A) Të ndryshueshme ose të pandryshueshme. B) Vetëm të pandryshueshme.
C) Gjithmonë të ndryshueshme. D) Të ndryshueshme sipas lakimit .
-

144. Dy fjalë të lidhura me një vizë (letrar - artistik) quhen:

- A) Të përbëra. B) Shprehje emërore.
C) Të përngjitura. D) Shprehje foljore.
-

145. Lidhëzat:

- A) Nuk janë gjymtyrë fjalie. B) Janë gjymtyrë të pavarura të fjalisë.
C) Janë gjymtyrë të varura të fjalisë. D) Janë gjymtyrë kryesore të fjalisë.
-

146. Në fjalinë " Mirit ose Olës i takon të flasë" -ose- është:

- A) Lidhëz bashkërenditëse veçuese. B) Lidhëz nënrenditëse veçuese.
C) Lidhëz bashkërenditëse shtuese. D) Lidhëz nënrenditëse shtuese.
-

147. Gjej pjesëzën në fjalinë "Kishte shumë njerëz atë ditë në kishë, sidomos gra e vajza".

- A) Sidomos. B) Shumë.
C) Në. D) Atë ditë.
-

148. Ndajfoljet janë:

- A) Pjesë të pandryshueshme. B) Janë pjesë të ndryshueshme sipas rasës.
C) Pjesë të ndryshueshme sipas numrit. D) Ndryshojnë formë para foljes.
-

149. Në fjalinë "Nuk u gjend askund" -askund- është:

- A) Ndajfolje vendi. B) Ndajfolje mënyre.
C) Ndajfolje sasi. D) Ndajfolje kohe.
-

150. "Për së shpejti" është:

- A) Shprehje ndajfoljore. B) Ndajfolje e përngjitur.
C) Ndajfolje e prejardhur. D) Ndajfolje fjalore.
-

151. Në fjalinë "vende-vende ishte zbardhur" -vende-vende- është:

- A) Ndajfolje vendi. B) Ndajfolje sasi.
C) Ndajfolje e pacaktuar. D) Ndajfolje foljore.
-

152. Cili është roli i parafjalëve në fjali sipas funksionit?

- A) Nuk kryejnë asnjë funksion të vetin në fjali. B) Kryejnë funksion përcaktori.
C) Kryejnë funksion rrethor. D) Kryejnë funksion kundrinori.
-

153. Në fjalinë "në lidhje me këtë problem" fjalët e nënvizuara janë:

- A) Shprehje parafoljore. B) Shprehje përemërore.
C) Shprehje ndajfoljore. D) Lidhëz.
-

154. Pjesa e nënvizur në fjalinë "në sajë të ndihmës suaj arritëm" është:

- A) Parafjalë e rasës gjinore. B) Parafjalë e rasës dhanore.
C) Parafjalë e rasës kallëzore. D) Parafjalë e rasës rrjedhore.
-

155. "U"(lodha) është:

- A) Pjesëz. B) Lidhëz.
C) Parafjalë. D) Parashitesë.
-

156. Fjala "njëditor" është formuar:

- A) Numëror + mbiemër. B) Numëror + emër.
C) Numëror + folje. D) Numëror + përemër.
-

157. Një fjalë i përket gjithmonë një klase?

- A) Po. B) Fjala nuk ka klasë.
C) Jo. D) Fjala ndryshon sipas klasave.
-

158. Gjej fjalën e shkruar në rregull.

- A) Vetushqyes. B) Vetë-ushqyes.
C) Vetëushqyes. D) Vet-ushqyes.
-

159. Tërësia e përdorimeve dhe e kuptimeve të një fjale quhet:

- A) Fushë kuptimore. B) Fushë fonetike.
C) Fushë leksikore. D) Kuptimësi.
-

160. "Pa" (lënë) është:

- A) Pjesëz. B) Lidhëz.
C) Parafjalë. D) Parashitesë.
-

161. "Fluturimthi" është:

- A) Ndajfolje e prejardhur. B) Shprehje emërore.
C) Shprehje ndajfoljore. D) Emër i prejardhur.
-

162. "Hem...hem" është:

- A) Lidhëz shtuese. B) Lidhëz veçuese.
C) Lidhëz kundërshtore. D) Lidhëz ftilluese.
-

163. Lidhëzat shërbejnë për të lidhur:

- A) Gjymtyrë të fjalisë. B) Për të lidhur fjalët në grupime emërore.
C) Fjalët në grupime. D) Për të bashkuar fjalët.
-

164. Cilat janë foljet kalimtare

- A) Foljet që pranojnë kundrinor të drejtë. B) Foljet që pranojnë kundrinor të zhdrejtë.
C) Foljet emërore. D) Janë folje që kalojnë nga një fjali në tjetrën.
-

165. Grup foljor quhet grupi i fjalëve që përbëhet nga:

- A) Një folje dhe plotësuesit e saj. B) Nga folje + emër.
C) Nga dy folje me kuptim të njëjtë. D) Nga folje + mbaresë.
-

166. Fjalja " edhe sikur të shpejtonte s' do të arrinte dot në kohë" është:

- A) Fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur lejore. B) Fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore.
C) Fjali e thjeshtë. D) Fjali e prejardhur.
-

167. "U munduam që të mos keqkuptoheshim" është fjali e :

- A) Përbërë me pjesë të nënrenditur qëllimore. B) Përbërë me pjesë të nënrenditur kushtore.
C) Përbërë me pjesë të nënrenditur lejore. D) Fjali e prejardhur.
-

168. Në fjalinë e përbërë dy pjesë të nënrenditura mund të bashkërenditen midis tyre?

- A) Po, kur janë të shkallës së parë.
B) Po, kur janë njëra e shkallës së parë tjetra e varur.
C) Po, kur janë të shkallës së dytë.
D) Jo.
-

169. Djali e pyeti se ku kishte lindur.

- A) Ligjëratë e zhdrejtë. B) Ligjëratë e stërholluar.
C) Ligjëratë e drejtë. D) Ligjëratë e ndërlikuar.
-

170. Trajtat e shkurtra të përemrit vetor shpesh qëndrojnë pranë:

- A) Foljes. B) Përemrit.
C) Emrit. D) Mbiemrit.
-

171. Në fjalinë "Do të të them një vjershë" gjej trajtën e shkurtër të përemrit vetor:

- A) Të-ja e dytë. B) Do.
C) Të-ja e parë. D) Them.
-

172. Pjesa e nënvizuar në fjalinë" Qante dhe qeshte nga befasimi" është:

- A) Rrethanor shkaku. B) Rrethanor vendi.
C) Rrethanor qëllimi. D) Kundrinor.
-

173. Rrethanori...

- A) Mund të hiqet nga fjalja pa prishur kuptimin a saj. B) Kryen funksion kundrinori.
C) S' mund të hiqet nga fjalja pa prishur kuptimin a saj. D) Shprehet me folje.
-

174. Kur foljet përdoren për të treguar një veprim të përfunduar në të shkuarën janë në kohën e:

- A) Kryer të thjeshtë. B) Pakryer.
C) Kryer. D) Më se të kryer.
-

175. Foljet që tregojnë një veprim që pritet të kryhet pas çastit kur flasim janë në:

- A) Kohën e ardhme. B) Kohën e pakryer .
C) Kohën e ardhme të përparme. D) Kohën e kryer.
-

176. Folja në të tashmen që paraqet si të gjallë një veprim të kryer në të shkuarën quhet:

- A) E tashme historike. B) E tashme.
C) E tashme e shkuar. D) E shkuar.
-

177. Dy pjesë kryesore të fjalisë së përbërë mund të bashkërenditen midis tyre?

- A) Po. B) Vetëm nënrenditen.
C) Po kur nënrenditen midis tyre. D) Jo.
-

178. Foljet që tregojnë një veprim që pritet të kryhet pas çastit kur flasim, para një veprimi tjetër janë në kohën e ...

- A) Ardhme të përparme. B) Të pakryer.
C) E ardhme. D) Të kryer.
-

179. Sa kohë ka mënyra lidhore?

- A) 4. B) 3.
C) 5. D) 6.
-

180. Folja "paskëshit mësuar" është në :

- A) Kohën më se të kryer, veta e dytë, shumës, mënyra habitore.
B) Kohën më se të kryer, veta e dytë, shumës, mënyra kushtore.
C) Kohën e kryer, veta e dytë, shumës, mënyra kushtore.
D) Kohën e kryer, veta e dytë, shumës, mënyra habitore.
-

181. Vendos foljen "ha" në mënyrën habitore, koha e kryer e thjeshtë , veta e tretë njëjës:

- A) -. B) Haja.
C) Hante. D) Të hante.
-

182. Vendos foljen "punoj" në mënyrën habitore, koha e kryer, veta e tretë njëjës:

- A) Paskam punuar. B) -.
C) Paskështa punuar. D) Punuakam.
-

183. Vendos foljen "lexoj" në kohën e pakryer të mënyrës kushtore, veta e tretë njëjës:

- A) -. B) Lexova.
C) Do të kisha lexuar. D) Do të kem lexuar.
-

184. Në ligjëratën e drejtë....

- A) Përsëriten me përpikmëri fjalët e personazhit. B) Fjalët thuhën me ritëm të drejtë.
C) Fjalët e personazhit paraqiten në formë të ndryshuar. D) Personazhi pohon një fakt.
-

185. A mund të shndërrohet një ligjëratë e drejtë në të zhdrejtë?

- A) Po. B) Në kushte të caktuara sintaksore.
C) Jo. D) Në kushte të caktuara morfologjike.
-

186. A vihet presje para lidhëzave kushtore?

- A) Po. B) Vihet para lidhëzave të thjeshta veçuese.
C) Jo. D) Vihet para lidhëzave të thjeshta shtuese.
-

187. Nuk vihet presje para:

- A) Para lidhëzave të thjeshta veçuese e shtuese. B) Lidhëzave kushtore.
C) Të gjitha lidhëzave. D) Vihet vetëm para lidhëzave shtuese.
-

188. "Kishte dëgjuar për detin por nuk e kishte parë atë asnjëherë" është:

- A) Fjali e përbërë me bashkërenditje kundërshtore. B) Fjali e përbërë me bashkërenditje kushtore.
C) Fjali e përbërë me nënrenditje kundërshtore. D) Fjali e përbërë me nënrenditje kushtore.
-

189. Në fjalinë e përbërë me më shumë se dy pjesë , pjesa e nënrenditur që varet drejtpërdrejt nga kryefjala është:

- A) E shkallës së parë. B) Kthehet në fjali bashkërenditëse.
C) E shkallës së dytë. D) Kthehet në fjali të thjeshtë.
-

190. " Nuk ishte çudi që Endri fitoi kupën" është fjali:

- A) Me nënrenditje filluese. B) Me bashkërenditje filluese.
C) Me nënrenditje shtuese. D) Me bashkërenditje shtuese.
-

191. "Me qëllim që " është:

- A) Shprehje lidhëzore. B) Lidhëz e përbërë.
C) Lidhëz e thjeshtë. D) Lidhëz e përngjitur.
-

192. Lidhëzat shërbejnë për të :

- A) Dy pjesë të një fjalie të përbërë.
B) Dy emra në fjalitë e përbëra.
C) Dy pjesë të një fjalie të përbërë me më shumë se dy fjali të nënrenditura.
D) Dy folje në fjalitë e përbëra.
-

193. Prapashtesat janë:

- A) Elemente të fjalës. B) Zanore.
C) Fjalë. D) Bashkëtingëllore.
-

194. Lidhëzat janë:

- A) Bashkërenditëse dhe nënrenditëse. B) Emërore dhe foljore.
C) Të thjeshta dhe të përbëra. D) Mbiemërore.
-

195. Sa klasa fjalësh ekzistojnë në gjuhën shqipe?

- A) 5. B) 6.
C) 4. D) 3.
-

196. Funkzioni i ndajfoljes në fjali kryesisht është:

- A) Si rrethanor. B) Si përcaktor.
C) Si kundrinor i drejtë. D) Si kundrinor i zhdrejtë.
-

197. Parafjalët janë :

- A) Të pandryshueshme. B) Ndryshojnë gjatë zgjedhimit.
C) Ndryshojnë gjatë lakimit. D) Të ndryshueshme.
-

198. "Akrep"(kafshë e vogël)" dhe "akrep"(i orës) janë:

- A) Homonime të mirëfillta. B) Homonime të pjesshme.
C) Sinonime. D) Antonime.
-

199. Kemi dy lloje fjalësh:

- A) Të thjeshta dhe jo të thjeshta. B) Të zgjedhura dhe të përbëra.
C) Të thjeshta dhe të përbëra. D) Të zgjedhura dhe të thjeshta.
-

200. Fjalori i parë i gjuhës shqipe (latinisht-shqip,1635) u hartua nga:

- A) Frang Bardhi. B) Pjetër Budi.
C) Pjetër Bogdani. D) Lekë Matrënga.
-

201. Fjala "qytetar" është:

- A) E prejardhur. B) E përbërë.
C) E thjeshtë. D) Foljore.
-

202. "Parandaloj" është formuar:

- A) Ndajfolje + folje. B) Parafjalë + folje.
C) Folje + folje. D) Parashtesë + folje.
-

203. Dy fjalë të bashkëngjitura formojnë një fjalë të:

- A) Përbërë. B) Thjeshtë.
C) Ndërlikuar. D) Prejardhur.
-

204. "Njëvjeçarë",

- A) Fjalë e përbërë. B) Fjalë e prejardhur.
C) Fjalë e thjeshtë. D) Fjalë e ndërlikuar.
-

205. Si shkruhet:

- A) Drejtqëndrim. B) Drejtqëndrim.
C) Drejtqëndrim. D) Drejtqndrim.
-

206. " I shumanshëm" është formuar:

- A) Përemër + mbiemër. B) Mbiemër + emër.
C) Përemër + emër. D) Mbiemër + mbiemër.
-

207. " Më shtrëngonte fort e më fort" -fort e më fort-është:

- A) Ndajfolje sasië. B) Përcaktor qëllimi.
C) Ndajfolje vendi. D) Përcaktor sasië.
-

208. Parafjalët janë fjalë që shprehin :

- A) Marrëdhënie midis fjalëve. B) Fjalë të përbëra.
C) Fjalë të thjeshta. D) Parashtesa.
-

209. Ndajfolja e kohës kryen funksionin e :

- A) Rrethanorit të kohës. B) Rrethanorit të shkakut.
C) Përcaktorit të kohës. D) Përcaktorit të shkakut.
-

210. " Më merr malli për shtëpinë" -për- është:

- A) Parafjalë e rasës kallëzore. B) Parafjalë e rasës gjinore.
C) Parafjalë e rasës dhanore. D) Ndajfolje shkakut.
-

211. Parafjala -për- në rasën dhanore bën:

- A) -. B) Pa.
C) Prej. D) Për të .
-

212. Në fjalinë e përbërë me bashkërenditje dy fjalitë janë të:

- A) Pavarura. B) Të përbëra.
C) Varura. D) Nënrenditura.
-

213. Kur njëra pjesë e fjalisë së përbërë tregon kusht :

- A) Përdoret presja. B) Përdoret pikëpresja.
C) Nuk përdoret shenjë pikësimi. D) Përdoret pika.
-

214. Folja -erdhe- është në kohën e :

- A) E kryer të thjeshtë. B) E pakryer.
C) Ardhme. D) Tashme.
-

215. Kur foljet tregojnë një veprim të përfunduar në të shkuarën por që lidhen me çastin kur flasim janë në :

- A) Kohën e kryer. B) Kohën e kryer të thjeshtë.
C) Kohën e pakryer. D) Tashme.
-

216. A ka kohë më se të kryer mënyra lidhore?

- A) Po. B) Jo, ka të ardhme.
C) Po; ka edhe të ardhme. D) Jo, ka të kryer të thjeshtë.
-

217. Sa kohë ka mënyra habitore?

- A) 4. B) 6.
C) 5. D) 3.
-

218. Folja -mësuakëshin- është në:

- A) Koha e pakryer, veta e tretë, shumës, mënyra habitore.
B) Koha e kryer, veta e tretë, shumës, mënyra habitore.
C) Koha e pakryer, veta e tretë, shumës, mënyra dëshirore.
D) Koha e kryer, veta e tretë, shumës, mënyra dëshirore.
-

219. Foljet që shprehin një veprim që mund të kryhej po të plotësohej një kusht i caktuar janë në :

- A) Mënyrën kushtore. B) Dëftore.
C) Mënyrën habitore. D) Lidhore.
-

220. E njëjta fjalë a ka të njëjtat shpjegime në fjalorë të ndryshëm?

- A) Jo.
B) E njëjta fjalë nuk mund të gjendet në dy fjalorë të ndryshëm.
C) Po.
D) Ka 4 lloje fjalorësh.

221. Sistemi i rregullave për të shqiptuar saktë fjalët quhet:

- A) Drejtshqiptim. B) Shqiptimor.
C) Drejshkrim. D) Gramatikë.

222. Për pyetjen "Sa i vjetër është sporti i futbollit?" përdorim :

- A) Fjalor enciklopedik. B) Fjalorë të zgjedhur.
C) Fjalor gjuhësor. D) Fjalorë të thjeshtë.

223. Vëllim poetik quhet:

- A) Vëllim me vjersha. B) Vëllim artistik.
C) Vëllim ku gjenden rregullat poetike. D) Vëllim poezish dhe tregimesh.

224. Folja - do t'i kem mbaruar- është në kohën e :

- A) Ardhme të përparme. B) Ardhme të tejshkuar .
C) Ardhme. D) Ardhme të prapme.

225. " Mbjellë" është:

- A) Pjesore. B) Paskajore.
C) Përcjellore. D) Folje.

226. Forma të pashtjelluara ka :

- A) Folja . B) Mbiemri.
C) Emri. D) Përemri.

227. Vendos foljen - mësoj- në kohën e pakryer të mënyrës habitore.

- A) Mësuakështa. B) Paskam mësuar.
C) Mësuakam. D) -.

228. Vendos foljen -fitoj- në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës habitore.

- A) -. B) Paskam fituar.
C) Fituakam. D) Kam fituar.

229. Në cilën kohë e mënyrë është folja "do të vinit"(po të kishit ftesë)?

- A) E tashme, kushtore. B) E ardhme ,kushtore.
C) E ardhme,lidhore. D) E pakryer, lidhore.

230. Secila nga pjesët e fjalisë së përbërë me bashkërenditje quhen:

- A) Pjesë të pavarura. B) Pjesë të varura.
C) Pjesë të nënrenditura. D) Pjesë të lehta.

231.Pjesa e nënrenditur, mund të qëndrojë si fjali më vete?

- A) Jo. B) Po, kur është e varur.
C)Po. D) Po, kur nuk është e varur.

232. "Po ta lësh, Flavia fle deri në drekë", është fjali e përbërë me pjesë të nënrenditur:

- A) Kushtore. B) S'ka pjesë të nënrenditur.
C) Lejore. D) Eshtë fjali e thjeshtë.

233. Ndajfoljet e sasisë, kryejnë funksionin e:

- A) Rrethanorit të sasisë. B) Përcaktorit të sasisë.
C) Përcaktorit. D) Kundrinorit.

234. Në fjalinë: "Hape dritaren, të lutem" folja -hape- është e zgjedhimit të ...

- A) Dytë. B) Tretë.
C) Parë. D) Katërt.

235. Vëmë foljen në kohën e tashme, veta e parë, njëjës për të dalluar:

- A) Zgjedhimin. B) Formën e emrit.
C) Lakimin. D) Ndajfoljen.

236. Folja "tregonte" është në:

- A) Koha e pakryer, veta e tretë, njëjës. B) Koha e kryer, veta e tretë, njëjës.
C)Koha e pakryer, veta e dytë, njëjës. D)Koha e kryer e thjeshtë, veta e tretë, njëjës.

237. Sipas mënyrës së formimit "përbri" është:

- A) Parafjalë e përngjitur. B) Folje e thjeshtë.
C) Emër foljor. D) Parafjalë e thjeshtë.

238. "Nga" dhe "tek" janë parafjalë të rasës:

- A) Emërore. B) Rrjedhore.
C) Gjinore. D) Dhanore.
-

239. Sipas mënyrës së formimit "bashkë me" është:

- A) Shprehje parafjalore. B) Parafjalë e përbërë.
C) Parafjalë e thjeshtë. D) Parafjalë e përngjitur.
-

240. Zakonisht pjesa e nënrenditur ffilluese e fjalisë së përbërë lidhet me pjesën kryesore me lidhëzat:

- A) Që, se. B) Që, prej.
C) Sepse, se. D) Prej, sepse.
-

241. Pjesët e nënrenditura rrethimore të fjalisë së përbërë mund të jenë:

- A) 6 lloje. B) 4 lloje.
C) 5 lloje. D) 7 lloje.
-

242. "Nesër" është:

- A) Ndajfolje kohe. B) Emër ndajfoljor.
C) Ndajfolje vendi. D) Emër foljor.
-

243. Parafjalët mund të lidhin:

- A) Emrin me foljen. B) Emrin me lidhëzat.
C) Emrin me parashtesën. D) Emrin me emër tjetër.
-

244. "Sot për sot" është:

- A) Shprehje ndajfoljore. B) Emër i përbërë.
C) Grup emëror. D) emër+nyje+emër.
-

245. Gjej fjalinë e shkruar saktë:

- A) Te shtëpia ime. B) Tek shtëpia ime.
C) Shtëpia ime tek. D) Shtëpia ime te.
-

246. Fjalitë e përbëra me më shumë pjesë të bashkërenditura mund të jenë ndërtuar:

- A) Me osa pa lidhëza. B) Pa lidhëza.
C) Me lidhëza. D) Me fjalë lidhëse.
-

247. Në fjalinë: "Përpara syve i doli fusha që ndriste nga dielli sa të merrte sytë",

pjesa e nënrenditur e shkallës së parë është:

- A) Përcaktore. B) Sasiore.
C) Mënyrore. D) Ffilluese.
-

248. Në fjalinë: "Përpara syve i doli fusha që ndriste nga dielli sa të merrte sytë",

pjesa e nënrenditur e shkallës së dytë është:

- A) Sasiore. B) Ffilluese.
C) Mënyrore. D) Përcaktore.
-

249. "Pasje vajtur" është folje në mënyrën:

